

VENDIM
Nr. 31, datë 27.4.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 4, DATË 29.2.2012, “PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORISË
SË KONSUMATORËVE PËR DISA KLIENTË TË VEÇANTË”**

Në mbështetje të nenit 14, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, dhe bazuar në relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit, Komisioni Kombëtar Rregullator, konstatoi:

Komisioni Kombëtar Rregullator, me anë të vendimit nr. 4, datë 29.2.2012, “Për përcaktimin e kategorisë së konsumatorëve për disa klientë të veçantë”, pika 1/b ka klasifikuar komunitetet fetare (selitë e tyre dhe objektet e kultit) në kategorinë e konsumatorëve publikë.

Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë, me anë të shkresës nr. 4/18, datë 25.2.2018, me lëndë “Mbi nevojën e rishikimit të tarifës së furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për objektet e bashkësive fetare” iu drejtua Entit Rregullator të Ujit, me kërkesën për kategorizimin e objekteve të bashkësive fetare si konsumatorë familjarë, mbështetur edhe në praktikën e ngjashme me shërbimin e furnizimit me energji elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 4, datë 29.2.2012, “Për përcaktimin e kategorisë së konsumatorëve për disa klientë të veçantë”, pika 1/b ndryshohet si më poshtë:

“Komunitetet fetare (selitë e tyre dhe objektet e kultit) të trajtohen në kategorinë “Klientë familjarë”. Këtu bëjnë përjashtim ato institucione dhe struktura të krijuara nga këto komunitete të cilat ushtrojnë veprimtari arsimore, shëndetësore dhe ekonomike, të cilat do të trajtohen në kategorinë “Klient privat”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit të njoftojë të gjitha shoqëritë ujësjellës-kanalizime dhe përfaqësitë e bashkësive fetare.

3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 1 qershor 2018.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani